



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjiçanit
Opština Gnjilane
Municipality of Gjiçane
Gjiçane Belediyesi

Në mbështetje të nenit 10, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6 të ligjit për Teatrot, nr.04/L-106, Kuvendi i Komunës së Gjiçanit në mbledhjen e mbajtur më 04.08.2023, miraton këtë:

RR E G U L L O R E (KGJ) NR. 1/2023

PËR SHFRYTËZIMIN E SALLËS SË MADHE TË TEATRIT TË QYTETIT GJILAN

Neni 1.

Salla e madhe e Teatrit të Qytetit Gjiçane mund të shfrytëzohet nga të interesuarit:

- Pa pagesë dhe
- Me pagesë

Neni 2.

Salla e Teatrit mund të shfrytëzohet pa pagesë vetëm në këto raste:

- Me rastin e manifestimeve/ festave shtetërore,
- Me rastin e organizimeve me qëllime jo profitabile nga organizatat, shoqatat humanitare, të dala nga lufta apo O.J.Q.-të e ndryshme kulturore.

Neni 3.

Salla e Teatrit mund të shfrytëzohet nga qytetarët/ institucionet/ organizatat me pagesë:

- Me çmim fiks, duke paguar 296 euro, që do të thotë 1€ për ulëse për tri (3) orë shfrytëzim (duke përfshirë vetëm sallën e ndriçuar dhe të pastruar).
- Me përqindje nga numri i tërësishëm i shitjes së biletave 70% për shfrytëzuesin dhe 30% për Teatrin.

3. TQGGJ ka të drejtën e plotësim ndryshimit të artikujve / shërbimeve dhe hapësirave tjera të Teatrit, të cilat nuk janë të përshkruara në këtë rregullore. Kjo bëhet varësisht të kërkesave shtesë të shfrytëzuesit. kurse vendimi nga Teatri merret në pajtueshmëri me dispozitat ligjore.

4. Me miratimin e kësaj rregulloreje, Drejtoria e Teatrit detyrohet të nxjerrë një çmimore ku listohen të gjitha llojet e shërbimeve dhe ofertave që u ofrohen shfrytëzuesve kundrejt pagesës për secilin shërbim veç e veç. Çmimorja duhet të bëhet publike pas hartimit të saj dhe aprovimit nga Këshilli Drejtues

Neni 4.

- 4.1. Shfrytëzimi i sallës nga Neni 2(dy), pika (a) i kësaj rregulloreje bëhet ekskluzivisht për festat më të rëndësishme shtetërore. Çdo manifestim tjetër duhet t'i nënshtrohet Neni 3 (tre).
- 4.2. Shfrytëzimi i sallës nga Neni 2 (dy), pika (b), bëhet në atë mënyrë që organizatat dhe shoqatat humanitare, të dala nga lufta si dhe O.J.Q.-të e ndryshme kulturore duhet ta parashtrorjnë kërkesën në afatin që përcakton kjo rregullore në Drejtorinë e Teatrit për të marr lejen e shfrytëzimit. Kjo nënkupton vetëm aktivitetet që kanë qëllime humanitare dhe jo profitabile, përndryshe shfrytëzuesi duhet t'i nënshtrohet Neni 3 (tre).
- 4.3. Po ashtu edhe çdo kërkesë tjetër nga të interesuarit për shfrytëzim duhet të bëhet së paku një (2) javë përpara datës së shfrytëzimit, pos në rastet e ndonjë komemoracioni. Edhe nëse kërkesa bëhet me kohë, kjo nuk siguron edhe miratimin e saj, përderisa kjo pengon procesin në të cilin ndodhet aktiviteti teatror dhe përderisa drejtoria nuk e njofton parashtruesin e kërkesës.

Neni 5.

Shfrytëzimi i sallës nga neni 3 (tre) i kësaj rregulloreje mund të bëhet si në vijim:

1. Të interesuarit mund ta shfrytëzojnë sallën e Teatrit të Qytetit Gjilan me përqindje 70/30, ku 70% i takojnë shfrytëzuesit, kurse 30% i takojnë Teatrit të Qytetit Gjilan. Kjo vlen vetëm për Teatrot profesioniste dhe për institucionet tjera që Drejtoria e Teatrit i konsideron si të rëndësishme dhe që përputhen me politikat e përgjithshme zhvillimore të Teatrit. Këtu kryesisht përfshihen shfaqjet teatrale, të baletit, operës, mjuziklit, muzikës serioze dhe koncepteve kreative nga sektori i pavarur i artit dhe kulturës.
2. Salla nuk mund të jepet për shfrytëzim për koncerte, përveç atyre të muzikës me vlera artistike dhe atyre që teatri i vlerëson si aktivitete që nuk dëmtojnë imazhin, politikën artistike të teatrit dhe sallën.

Neni 6.

- 6.1. Salla dhe skena do të kontrollohen paraprakisht dhe shfrytëzuesi do të njoftohet mbi gjendjen e përgjithshme. Pas aktivitetit shfrytëzuesi ka për detyrë që të lajmëroj përfundimin e aktivitetit në drejtori dhe me personin adekuat nga Teatri i Qytetit Gjilan do të bëhet një kontroll mbi gjendjen e përgjithshme në sallë dhe skenë.
- 6.2. Po që se vlerësohet se janë bërë dëme apo mungon diçka atëherë shfrytëzuesi merr të gjitha përgjegjësitë dhe obligohet që t'i paguaj, riprodhoj apo riparoj të gjitha dëmet e shkaktuara gjatë kohës së shfrytëzimit të sallës.

Neni 7.

- 7.1. Në rast se gjatë shfrytëzimit të sallës përdoret skena dhe prapaskena, e sidomos nga të rinjtë apo fëmijët, shfrytëzuesi është i obliguar që të ketë në dispozicion mbikqyrës të rritur kompetent. Deri në 15 fëmijë apo të rinj duhet të ketë 1(një) mbikqyrës të rritur.
- 7.2. Në rast se shfrytëzuesi kërkon të përdoren grimoret duhet të negocioj me drejtorinë për të marrë leje. Të gjitha rregullat që gjenden në Nenin 6(gjashtë), vlejnjë edhe për grimoret.
- 7.3. Në sallë, skenë, prapaskenë dhe grimore ndalohet rreptësisht pirja e duhanit dhe ngrënia e gjërave ushqimore.

Neni 8.

- 8.1. Për zbatimin e kësaj rregulloreje do të kujdeset Organi Ekzekutiv i Teatrit.
- 8.2. Mbikëqyrjen e realizimit të kësaj rregulloreje e bënë Këshilli Drejtues i Teatrit.

Neni 9.

Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 pesëmbëdhjetë) pas regjistrimit në Zyren e protokolit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në web faqën e Komunës së Gjilanit.

KUVENDI I KOMUNËS SË GJILANIT

01. Nr.016-85510
Gjilan, më 04.08.2023



Kryesuesi i Kuvendit

[Signature]
/Kushtrim Kadriu/